



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, BUXHETIT DHE KOMUNIKIMIT

**SHPALLJE PËR NJË VEND TË LIRE PUNE,
LËVIZJE PARALELE DHE NGRITJE NË DETYRË**

**“Inspektor” në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Tregjeve të
Shërbimit/Joprodhuese
Kategoria e pagës III-1**

Në zbatim të nenit 25 dhe 26, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, ndryshuar me të fundit nr. 748, datë 19.12.2018, Autoriteti i Konkurrencës shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për pozicionin në kategorinë e ulët drejtuese:

- “Inspektor” në Drejtorinë e Mbikëqyrjes së Tregjeve të Shërbimit/Joprodhuese
- Kategoria e pagës III-1

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

**Për procedurat (lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë) aplikohet
në të njëjtën kohë!**

Afati për dorëzimin e dokumenteve:

14 maj 2026

***Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit është i njëjtë për të dyja procedurat.**



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
A U T O R I T E T I I K O N K U R R E N C Ë S
D R E J T O R I A E B U R I M E V E N J E R Ë Z O R E , B U X H E T I T D H E K O M U N I K I M I T

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin e mësipërm është:

Inspektori realizon inspektime administrative në bazë të kreut II, Procedurat e përgjithshme administrative, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, pranë ndërmarrjeve nën hetim administrativ, sipas autorizimit përkatës të Komisionit të Konkurrencës, si dhe së bashku me drejtorin e drejtorisë propozon vendosjen e sanksioneve për shkeljet e konstatuara, monitoron zbatimin e vendimeve të Komisionit, si dhe kryen monitorime në lidhje me tregjet e shërbimit/joprodhuese, që ka për detyrë të mbikëqyrë. Inspektori kryen vlerësime ligjore mbi aktet ligjore dhe/ose nënligjore në fuqi, të cilat mund të sjellin kufizime të konkurrencës në tregjet e shërbimit/ joprodhuese që ai mbikëqyrë. Inspektori bën vlerësimin e ankesave rast pas rasti sipas ndarjeve të punëve nga drejtori i drejtorisë, në zbatim të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, duke bërë propozimet përkatëse. Ruan konfidencialitetin zyrtar dhe tregtar për informacionet e dokumentuara, të marra nga subjektet tregtare dhe institucionet publike, entet rregullatore, shoqatat profesionale e tregtare dhe palë të tjera të interesuara.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil.

1.- Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori (kategoria III-1);
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vërtetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën një vlerësim pozitiv (për kandidatët e institucioneve që sapo kanë hyrë në shërbimin civil kërkohet vlerësim nga eprori direkt).

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë të nivelit “Master shkencor” në fushën e drejtësisë;
- b) Të zotërojnë njohuri shumë të mira profesionale në këtë fushë;
- c) Avantazh do të përbëjnë dhe studime apo diploma të tjera pasuniversitare në këtë fushë;
- d) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet në nivel të ulët drejtues;
- e) Të zotërojnë gjuhën angleze dhe çdo gjuhë e dytë e vendeve të BE përbën avantazh.



R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
A U T O R I T E T I I K O N K U R R E N C Ë S
D R E J T O R I A E B U R I M E V E N J E R Ë Z O R E , B U X H E T I T D H E K O M U N I K I M I T

2.- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë përgjegjëse të burimeve njerëzore të Autoritetit të Konkurrencës ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentet si më poshtë:

a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

b) fotokopje të diplomës;

c) fotokopje të librezës;

d) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

e) Vërtetimi i gjendjes gjyqësore;

f) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;

g) Numër kontakti dhe adresë vendbanimi.

Dokumentet duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 14 maj 2026.

3.- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën **15 maj 2026**, njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore të Autoritetit të Konkurrencës, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

4.- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

a) Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar;

b) Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, BUXHETIT DHE KOMUNIKIMIT

- c) Konkurrimi do të bazohet dhe në njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij, Politika Kombëtare e Konkurrencës, Kodin e Procedurave Administrative;
- d) *Për më shumë:* www.caa.gov.al

5.- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 të Departamentit të Administratës Publike www.dap.gov.al.

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta>

6.- Data e daljes së rezultateve të konkurrimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti i Konkurrencës do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen zyrtare të AK. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

II- Ngritja në detyrë

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurrimin nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 26 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësit civil”, i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e ngritjes në detyrë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, BUXHETIT DHE KOMUNIKIMIT

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të zotërojnë diplomë të arsimit të lartë të nivelit “Master shkencor” në fushën e drejtësisë;
- b) Të zotërojnë njohuri shumë të mira profesionale në këtë fushë;
- c) Avantazh do të përbëjnë dhe studime apo diploma të tjera pasuniversitare në këtë fushë;
- d) Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet në nivel ekzekutiv;
- e) Të zotërojnë gjuhën angleze dhe çdo gjuhë e dytë e vendeve të BE përbën avantazh.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

- a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

- b) fotokopje të diplomës dhe listës se notave;
- c) fotokopje të librezës se punës;
- d) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;
- e) Vërtetimi i gjendjes gjyqësore;
- f) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g) Numër kontakti dhe adresë vendbanimi.

*Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentet e cituara më sipër me poste ose dorazi, brenda datës **14 maj 2026** në Autoritetin e Konkurrencës me adresë: Rruga “Sami Frashëri”, kati IV. Nr.4.*

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e ngritjes në detyrë do të marrin informacion në faqen e Autoritetit të Konkurrencës për fazat e mëtejshme të kësaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Autoritetit të Konkurrencës duke filluar nga data **15 maj 2026**.

Tiranë, më 29.04.2026